



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 816 Prot.

Tiranë, më 07.062019

VENDIM Nr. 135, datë 28.05.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 28.05.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC IBALLA 1, IBALLA 2, SAPAÇ 1, SAPAÇ 2, BERISHË dhe LIQENI"*, lumi i Iballës dhe Sapaçit, Bashkia Fushë-Arrëz-subjekti "NOVO SAPAC ENERGIE" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC IBALLA 1, IBALLA 2, SAPAÇ 1, SAPAÇ 2, BERISHË dhe LIQENI"*, lumi i Iballës dhe Sapaçit, Bashkia Fushë-Arrëz- subjekti "NOVO SAPAC ENERGIE" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "NOVO SAPAC ENERGIE" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC IBALLA 1, IBALLA 2, SAPAÇ 1, SAPAÇ 2, BERISHË dhe LIQENI", lumi i Iballës dhe Sapaçit, Bashkia Fushë-Arrëz, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresë: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al